



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2815 Prot.

Lezhë, më 3 . 3 . 2022

**VENDIM**

Nr. 21 Datë 28 . 02 . 2022

**Për përdorimin e fondit të emergjencës për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qirasë së banesës) për familjen e znj.A.F.L , pasi ka dalë e pastrehë nga dëmtimi i banesës nga rënia e gurit.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, të VKM nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar për Mbrojtjen Civile”; ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**VENDOSI:**

1.Miratimin e përdorimit të fondit të emergjencës në shumën 102,000 lekë për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qirasë së banesës) për familjen e A.F.L , banuese në Shëngjin, pasi banesa e saj është bërë e pabanueshme si shkak i dëmtimit nga rënia e gurit.

Për këtë të kryhen veprimet në programin buxhetor Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art./llog.ek.606 për shumën 102,000 lekë.

2. Mbulimi i qirasë së banesës do të jetë për periudhën 01.01.2022 - 30.06.2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI**

**ERNEST RAKAJ**